

VENDIM
Nr.856, datë 14.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “BLERJE APARATI ECHO-JE PORTABËL, PËR SOBIN DHE SHËRBIMIN PARËSOR TË ASHR-SË”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR), Tiranë, të përfundojë brenda datës 26 dhjetor 2011, procedurën e prokurimit me objekt “Blerje aparati *Echo*-je portabël për Sobin dhe shërbimin parësor të ASHR-së”, me fond limit 4 583 333 (katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tri mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekësh, pa TVSH.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratës dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha